mesatare e tyre te mos jete me e vogel se vlera e fondit limit.

2.2.2 Operatori ekonomike duhet te kete nje aktivitet te qendrueshem gjate tre viteve 2015,2016,2017 .Per te vertetuar plotesimine ketij kushti Operatori Ekonomike duhet te paraqese kopje te bilanceve te kketyre viteve ,te paraqitura prane autoritetit perkates ,te konfirmuar me shkrese te vecantenga autoriteti si dhe te shoqeruar nga akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabel i autorizuar.

2.2.3 Operatori Ekonomike duhet te disponoj vlera te mjaftueshme monetare per te reaizuar objektin e tenderit pa marr paradhenie.Operatori duhet te paraqese vertetim nga nje apo shume banka per gjendjen financiare ne vleren jo me te vogel se 10%te vleres se fondit limitte leshuar jo me pare se 10 dite nga hapja e ofertave.

2.2.4 Operatori duhet te kete plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore ,nga administrata e qevewrisjes vendore ku operatori ka kryer aktivitet per vitet 2018.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomike duhet te kete realizuar pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlere jo me pak se 50% e vleres se fondit limit dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit, ose pune te ngjashme deri ne nje kufi ,ku vlera monetare te kryera,e marre se bashku,gjate tre viteve te fundit eshte jo me pak se dyfishi i vleres se fondit limit dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

Plotesimi i njerit prej 2 kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomike duhet te paraqese formularin e vleresimit sipas shtojces perkatese te dst-se te shoqeruara me kontrate e nenshkrara nga palet ,situacionin perfundimtare,akte kualidimin.

2.3.2 OE duhet te kete mesatarisht te punesuar minimalisht 50 persona per periudhen (janar 2017 –shkurt 2018),te vertetuara me; Vertetim te leshuar nga administrata tatimore per periudhen e kerkuar dhe me formularin E-SIG ,list pagesen per periudhen (janar 2017-shkurt 2018).Bashke me formularet e urdher pagesave..

2.3.3/a .Operatori Ekonomike duhet te vertetoj se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt.Per kete operatori duhet te paraqese dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar ne organet tatimore;

Nje 1 inxhinjer ndertimi,1 nje inxhinjer hidroteknike,1 nje inxhinjer mekanike,1 nje inxhinjer elektrike,1 nje inxhinjer topograf ,1 nje inxhinjer mjedisi .Te shoqeruar per secilin punonjes me diplome ,kontrate pune dhe CV.

2.3.4

Operatori Ekonomike duhet te punesoj te pakten 20 punonjes te paisur me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuara nga institutet e akredituara ekujvalente me to ku te jene perfshire;

1.Karpentier me kontrate pune ,deshmi kuafikimi,e sigurimi teknike 3 te punesuar.

2.Manovraore per makineri te renda,r me kontrate pune ,deshmi kuafikimi,e sigurimi teknike 3 te punesuar.

3.Hekurkethyes shoqeruar me kontrate pune ,deshmi kuafikimi,e sigurimi teknike 2 te punesuar.

4. murator shoqeruar me kontrate pune ,deshmi kuafikimi,e sigurimi teknike 3 te punesuar.

Dokumenta Standarde të Tenderit

5. shofere me kontrate pune , leje drejtimi 4 te punesuar.
 6. Teknike ndertimi me kontrate pune ,deshmi kuaifikimi,e sigurimi teknike 1 te punesuar.
 7. Elekriciste me kontrate pune ,deshmi kuaifikimi,e sigurimi teknike 1 te punesuar.
 8. Mekanike me kontrate pune ,deshmi kuaifikimi,e sigurimi teknike 2 te punesuar.
 9. Saldator me kontrate pune ,deshmi kuaifikimi,e sigurimi teknike 1 te punesuar.
- 2.3.5 Operatori Ekonomike duhet te kete ne stafin e tij nga janar 2017 e ne vazhdim mjekun e shoqerise ne zbatim te vendimit perkates vkm nr 742 date 06.11.2003.Ne rast te B.O.E te plotesoj ky kriter te pakten nga njeri prej antareve .Per kete duhet te paraqese kontrate noteriale te punes,diplome,license perkatese.

2.3.6 Operatori Eknomike duhet te disponoj licensat e nevojshme per zbatimin e kontratave.Per kete duhet te paraqese licensat perkatese te shoqerise sipas vkm-se.Licensa duhet te permbaj kadegorit t e meposhtme;

Per punimet e pergjithshme;

Licensa N.P-1B punime me germime ne toke

N.P-2A ndertime civile dhe industriale

N.P-3A rikonstrukcion dhe mirmbajtje godinash

N.P-4B rruge autorstrada ,mbikalime etj

N.P-5A punime nentoksoreura vepra arti

N.P-9A punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

N.P-12A punime te inxhinjerise se mjedisit.

Per punimet speciale te ndertimit duhet te kete licensa e meposhtme;

Licensa; NS-1A punime Prishje ndertime

N.S-4A punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to

N.S- 5A impjante sinjalistike ndricuese te trafikut

N.S- 6A sinjalistike rrugore jo ndricuese

N.S -7A barriera per mbrojtje rrugore.

N.S -13A impjante dhe linja telefonike dhe telekomunikacion

N.S -18A punime topo gjeodezike.

2.3.7 Operatori duhet te disponoj mjete dhe paisje e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjete dhe paisje teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion OE.

Kerkohen keto mjete pune;

Nr	Lloji i makinerise	disponimi	sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 15 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope 4
2	kamiocin	Ne pronesi ose me qera	Cope 2
3	Furgo per transport puntoresh	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
4	Grejder	Ne pronesi ose me qera	Cope2
5	Rrul 8-9ton	Ne pronesi ose me qera	Cope 1

Dokumenta Standarde të Tenderit

6	<i>Rrul mbi 15ton</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
7	<i>Asfaltoshtrues</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
8	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
9	<i>Eskavator me zinxhire</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
10	<i>Skrep/fadrom</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
11	<i>Minieskavator</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
12	<i>Minifadrom</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
13	<i>Kamion vinc mbi 15 ton</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
14	<i>Autobetoniere</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 4</i>
15	<i>Autopompe/prese betoni</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
16	<i>Armature metalike per betonim</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>200m2</i>
17	<i>Betoniere kantieri 2.5m3</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
18	<i>Vibrator betoni</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
19	<i>Motosaldatrice</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
20	<i>Gjenratore</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
21	<i>Autobot uji kapacitet 10mije litra</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
22	<i>Buldozer me zinxhire</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
23	<i>Motorshare asfalti</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
24	<i>Prerese pllakash</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
25	<i>Kontenier per zyra te levizeshme per staf</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
26	<i>Cekic pneumatik</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
27	<i>Aparat saldimi tubo plastike</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
28	<i>Kompaktor per ngjeshje pllakash</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
29	<i>Tabela sinjalistike rrugore te ndryshme</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
30	<i>Fabrike betoni shoqeruar me dokumenta pronesie</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
31	<i>Nyje te gurit dekorativ dhe gelqeror shoqeruar me qkb dhe dokumentet per leje shfrytezimi nga ministria perkatese leje mjedisore</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
32	<i>Makineri per prodhimin pllake dhe bordure</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>

Pert makinerite te pllakave dhe bordurave duhet te paraqiten si me posht;

QKL –Leje mjedisi te tipit B Kodi IIIA PER impjante e produkteve te betonit ,shoqeruar me planvendosje per impjantin dhe monotorimin mjedisor ,leshuar 5 muaj te fundit.

QKL- Leje mjedisi kodi ;III 1A per impjante inertesh.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Per linjen e prodhimit te elementeve te betonit ,pllaka bordura,duhet te paraqitet kontrate blerje ose me qera,skema teknologjike e makinerise ,te jete paisur me leje mjedisore ,nga qkl ,formular zhdoganimi si dhe certifikate sipas standarteve EN ISO 9001;2015 BSOHSAS 18001;2007 BSISO 39001;2012 EN-ISO 14001;2015.

Per paisjet teknike te cilat jane ne pronesi te subjektit duhet te paraqiten kontrata shitblerje dhe fatura tatimore te shitjes, kur merren me qera duhet kantrata e qerase ,faturat tatimore te shitjes dhe kontratat e shitblerjes .Fatura e biznesit te vogel shoqerohen me kupon tatimore.

Per mjete me goma qe shenohen ne regjistra publike kur jane ne pronesi duhet te paraqesin dokumenta e pronesise se mjetit ,certifikate pronesie leje qarkullimi certifikaten e kontrollit teknike ,vertetim pagese taksa vjetore ,tahografi certifikate traqnsporti mallrash dhe foto perkatese ,ndersa per mjete me qera pervec dokumentacionit te mesiperme duhet edhe kontrata e qerase e noterizuar.

Per mjete qe nuk shenohen ne regjistra publike kur jane ne pronesi duhet parasqitur kontrata e blerjes apo cdoganimi foto dhe fatura tatimore perkatese ,permjetet me qera krahas dokumentave te mesiperme edhe kontrata e qerase se noterizuar.

2.3.8 Makinerit e mesiperme nuk duhet te jene angazhuar ne tjeter tender e shoqeruar edhe me deklarate e administratorit i shoqerise per kete ceshtje.

2.3.10 Operatori duhet te disponoj certifikata;

ISO 9001-2015 ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

ISO 14001-2015 ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

ISO OHSAS 18001-2007 ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

ISO PAS 99-2012 ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

BSISO 39001-2012 ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

ISO/IEC 27001;2013 per sigurin e informacinit ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

ISO 5001;2011 manaxhim te energjise ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

EN-ISO 3834-2;2006 per cilesin ne saldim ne rast bashkim operatori te jete plotesuar nga nje antare.

Certifikata te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, dhe te jene ne perputhje vkm .certifikatat te jene ne gjuhen shqipe te perkthyer dhe te noterizuara.

Autoriteti kontraktor rezervon te verifikimt te vertetesise te te gjitha deklaratave te mesiperme.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 12



(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

.Përshkrim i punëve

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:Projekti prane sekretarise Spitali Berat.

Nr	Nr An	Emertimi	Njesia	sasia	cmimi	vlera
1	3.158/e	Germime dhe transport me dhe auto	M3	192.6		
2	3.212/c	Shtrese stabilizanti 15(10+5)	M3	1900		
3	3.241	Shtrese betoni c12/15 per bazamentin e bordurave	M3	10		
4	3.617	f.v bordura betoni 15x30cm	ml	162		
5	2.262/3	Beton c16/20 per fiksime bordure	M3	5		
6	3.212/a	Shtresa granili t=5cm	M2	1900		

Dokumenta Standarde të Tenderit

7	2.263	Shtresa pllake dekorative betoni t-8cm	M2	1900		
8	2.37/5b	Transport dheu me auto	M3	450		
1	3.158/e	Germim transport dheu me auto	M3	250		
2	3.211	Shtrese cakulli mbeturina kave t=20cm perhapur e ngjeshur makineri	M2	90		
3	3.212/c	Shtrese stabilizanti 15(10+5)	M2	90		
4	3.226/3	Shtrese asfaltobetoni 6 cm	M2	405		
5	3.244/1	f.v beton c16/20 per kunetat	M3	9		
6	2.555	Tube betoni fi500	ml	20		
7	2.262/4a	Kapak betoni c20/25 per kanalet	M3	5		
8	2.523/1	f.v tuba binjezuar fi 200mm	ml	24		
9	An-22	Puset b/a shiu 40x60 cm h=100cm me kapak zgare hekuri	cope	8		
10	Analize	F+v pllaka guri per kunete	M2	81		
11	2.263	Shtrese pllaka dekorative betoni t-6cm	M2	162		

Pwrshkrimi i tw dhwnave teknike tw mallrave objekt prokurimi tw përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr	Nr An	Emertimi	Njesia	sasia	cmimi	vlera
1	3.158/e	Germime dhe transport me dhe auto	M3	192.6		
2	3.212/c	Shtrese stabilizanti 15(10+5)	M3	1900		
3	3.241	Shtrese betoni c12/15 per bazamentin e bordurave	M3	10		
4	3.617	f.v bordura betoni 15x30cm	ml	162		
5	2.262/3	Beton c16/20 per fiksime bordure	M3	5		
6	3.212/a	Shtresa granili t=5cm	M2	1900		
7	2.263	Shtresa pllake dekorative betoni t-8cm	M2	1900		
8	2.37/5b	Transport dheu me auto	M3	450		
1	3.158/e	Germim transport dheu me auto	M3	250		
2	3.211	Shtrese cakulli mbeturina kave t=20cm perhapur e ngjeshur makineri	M2	90		
3	3.212/c	Shtrese stabilizanti 15(10+5)	M2	90		
4	3.226/3	Shtrese asfaltobetoni 6 cm	M2	405		
5	3.244/1	f.v beton c16/20 per kunetat	M3	9		
6	2.555	Tubo betoni fi500	ml	20		
7	2.262/4a	Kapak betoni c20/25 per kanalet	M3	5		
8	2.523/1	f.v tuba binjezuar fi 200mm	ml	24		
9	An-22	Puset b/a shiu 40x60 cm h=100cm me kapak zgare hekuri	cope	8		
10	Analize	F+v pllaka guri per kunete	M2	81		
11	2.263	Shtrese pllaka dekorative betoni t-6cm	M2	162		

Dokumenta Standarde të Tenderit

--	--	--	--	--	--	--



Shtojca 14.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të

Dokumenta Standarde të Tenderit

shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e për zgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë) **Public Health Sector**

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vërtetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë ne Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të

Dokumenta Standarde të Tenderit

cilën do të paguhet paradhenia.

- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke

sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë

procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
- 21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

- 22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

- 23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:
- dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
 - dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit së Plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

